Të dhënat teknike të punëve objekt prokurimi duhet të përshkruhen sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

SHËNIM: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Skicimet, parametrat teknik etj: ***Bashkëlidhur DST***

Specifikimi i Materialeve: ***Bashkëlidhur DST***

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: ***Bashkëlidhur DST***

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

GRAFIKUT I ZBATIMIT TË PUNIMEVE

Afatet e realizimit të punimeve:

Nr	Pershkrimi i Punimeve	Gjithsej 7Muaj						
		M.1	M.2	M.3	M.4	M.5	M.6	M.7
	1.Argjinatura							
1	Germim dheu me ekskavator zingjir 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, prani uji ~ 2m, kategoria III, me shk ne mjet							
2	Mbushje me zhavorr pas mureve,(argjinatura)							
3	Mbushjeme zhavorr pas mureve (pas mureve+gabionit)							
4	Shtrese zhavorr lumi (=10cm(muri I betonit)							
5	Shtrese betoni C 12/15(muri I betonit)							
6	Tub Ø90 mm per kullimin e ujrave ne mure (muri I betonit)							
7	Struktura monilite betoni C25/30 (muri I betonit)							
8	Struktura monolite betoni C 16/20(argjinatura)							
9	Gabiona me rrjete teli te zinguar e gure kave 1x1x1 m							
10	Gabiona me rrjete teli te zinguar, gure kave 1x1x2 m							
11	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 3.0 km							
	2.Sistemimi i kanalit							
1	Germim dheu me ekskavator zingjir 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, prani uji ~ 2m, kategoria III, me shk ne mjet							
2	Mbushje me zhavorr pas mureve,(kesoni)							
3	Shtrese zhavorr lumi (=10cm(kesoni)							
4	Shtrese betoni C 12/15(kesoni)							
5	Kesone b/a							

Shënim. Autoriteti/enti kontraktor mund të shtojë rreshta në varësi të zërave të punimeve dhe kollona në varësi të afatit të parashikuar për realizimin e tyre.

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

KRITERET E VEÇANTA TE KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet te paraqese:

- a. *Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit, sipas shtojces 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertes, sipas Shtojces 3;*

Argumentimi: Kriteri (a) është vendosur në bazë të nenit 83 të LPP dhe nenit 30 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Kriteri (b) bazohet në nenet 76, 77 dhe 82 të LPP si dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

Ofertuesi duhet te paraqese:

2.1 Pershtatshmeria per te kryer veprimtarine profesionale:

Sipas kriterëve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 7).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar si dhe në ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të biznesit”, të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Per te provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2021, 2022** dhe **2023**, ku vlera e xhiros për 3 (tre) vitet e fundit duhet të jete jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 shkronja c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar . Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosija e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2021, 2022,** dhe **2023**, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të *ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009*, ku bilancet e dy viteve

te njepasnjeshme, nuk duhet te kene raport negativ ndermjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur referuar nenit 43, pika 4 te VKM-së Nr.285 datë 05.03.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” I ndryshuar , si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe Ligjin nr.10091“Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.i cili parashikon se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Pushteti Vendor, për vitin 2023 ne te gjitha vendet ku ka ushtruar aktivitetin referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument ne momentin e dorëzimit te dokumentave).

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i ka shlyer detyrimet e taksave dhe të tarifave vendore për vitin 2023, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes se kontrates.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar sipas të cilit operatorët ekonomikë duhet të shlyejnë detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në çdo adresë ku ushtrojnë aktivitetin, neni 5, pika c, sipas afateve te miratuara te kryerjes se pagesave te percaktuara nga cdo njesi e qeverisjes vendore, në Ligjin Nr. 9 920, datë 19.05.2008 ”Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin Nr. 131/2015 ”Për QKB” i ndryshuar si dhe në Ligjin Nr. 9 723, datë 03.05.2007 ”Për QKR”, i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vleres se përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së

bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit e kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojen e mëparshme duhet të paraqiten:

- **Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore:**
 - a) Kontraten e Siper marrjes,
 - b) Situacionin perfundimtar te objektit
 - c) Fatura Tatimore
 - d) Aktin e Kolaudimit te objektit
 - e) Formular Vleresimi nga Investitori sipas shtojces nr. 9
 - f) Çertifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përfundimtar të punimeve.

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- **Nëse kontrata është realizuar me subjekte private:**
 - a) Kontraten e Siper marrjes,
 - b) Situacionin perfundimtar te objektit
 - c) Faturat Tatimore
 - d) Aktin e Kolaudimit te objektit

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojen e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.

Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

- Kontraten e bashkimit te operatoreve dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit;
- Per kontratat e realizuara si Nenkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

Kontratë baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor.

Formular vlerësimi

Situacion Përfundimtar & Faturat Tatimore

Pika a) plotësohet nga anetari i cili ka përqindjen me të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anetaret e tjere të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme ne raport me përqindjen e pjesëmarrjes se tyre ne bashkim. Kurse **pika b)** duhet te plotësohet nga te gjithë anetaret e bashkimit ne raport me përqindjen e pjesëmarrjes se tyre ne bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo me të vogël se dyfishi i vlerës limit të objektit të prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit te operatoreve

shoqeruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku te cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE, mbështetur në parashikimet e nenit 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij dokumentacioni AK ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE.

2.3.2 Operoret ekonomike duhet të deshmojnë se disponojnë liçense profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçense të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontrates. Për këto duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “*Per miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”, i ndryshuar. Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontrates duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

RISHKIM PERKATES SHOQERUAR ME TABELEN

Per punimet e pergjithshme te ndertimit:

- Kategoria NP-1 – Klasifikimi A
- Kategoria NP-9 – Klasifikimi A

▪ Për punimet speciale të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:

- Kategoria NS-18 – Klasifikimi A

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (lidhja 2, 3 dhe 4).

* *Per Operoret e huaj te behet njehesimi i licenses profesionale qe disponojne nga vendi i origjines prane Ministrise se Puneve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit ne plotesimin e liçensave profesionale te kerkuara per ekzekutimin e kontrates.*

* Ne rast te bashkimit te operatoreve ekonomike, Licensat profesionale duhet t'i paraqese operatori ekonomik qe ka marre persiper punimet per te cilat kerkohe Licensa Profesionale.

Kategori a e kërkua	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	Punime gjurmimi në tokë.	Punime gjurmim dheu	A	0-20 milion
NP-9	Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime.	Punime argjinature, shtresa betoni, kesone per rehabilitimin e perroit	A	0-20 milion
NS-18	Punime topogjeodezike.	Punimet per piketimin dhe mbarvajtjes gjate gjithë	A	0-20 ilion

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet te paraqese Çertifikaten ISO, si me poshte:

- **ISO 9001:2015 (Sistem i Menaxhimit te Cilesise)**
- **ISO 14001:2015 (Sistem i Menaxhimit Mjedisor)**
- **ISO 45001:2018 (Sistem i Menaxhimi i sigurise dhe Shendetit ne pune)**

Çertifikata e mesiperme duhet te jete e vlefshme ne daten e hapjes se ofertave. Nese çertifikata eshte ne gjuhe te huaj duhet te shoqerohet me perkthimin ne gjuhen shqipe te noterizuar. Çertifikata e mesiperme duhet te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise.

Ne rast te bashkimit te operatoreve ekonomike ISO duhet plotesuar nga operatorët ekonomike, sipas natyres se puneve qe marrin persiper.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, si dhe nenit nr. 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020“Për prokurimin publik” dhe bazuar ne nenin 44 pika 1, e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardete kërkuara të cilësisë.Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Duke qenë se përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi është Autoriteti Kontraktor,gëzon të drejtën për t’u garantuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për punët që do të kryhen, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar ”.

- Për ISO 9001 - 2015; Kjo çertifikate specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë,ku një operator ekonomik duhet të tregojë aftësinë e tij që vazhdimisht të sigurojë punë/mallra ose shërbime që plotësojnë kërkesat e aplikueshme ligjore dhe rregullatore, si dhe synon të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit duke përfshirë edhe proceset për përmirësim të vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit të klientit dhe kushtet e aplikueshme ligjore dhe rregullatore si dhe meqënëse Bashkia Selenice si Autoritet Kontraktor kërkon që punimet që do të kryhen të jenë në cilësinë më të lartë është përcaktuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me këtë standart cilësie.

- Per ISO 14001 – 2015: Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 14001 – 2015, standart ky që vlerëson sipas përkufizimit të tij përgjegjshmërinë e kompanive ndaj mjedisit. Standardet e Sistemit të Menaxhimit - që vlerësojnë nivelin e sistemit të zhvillimit dhe integritit të përgjegjësive ndaj mjedisit në të gjithë kompaninë. Bashkia Selenice si Autoritet Kontraktor kërkon një manaxhim të aktivitetit përkushtuar parandalimit të ndotjes dhe të përmirësimit të ndikimeve mjedisore.

- Per ISO 45001:2018: Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 45001:2018, standart ky që përcakton kërkesat minimale të shëndetit në punë dhe praktikën më të mira të menaxhimit të sigurisë. Ky lloj standarti konsiston në sigurimin e një sistemi shëndetësor optimal dhe menaxhimin e sigurisë në punë. Kjo mund të ndihmojë për të vënë në vend politikën, procedurat dhe kontrollet e nevojshme për çdo lloj biznesi për të arritur kushtet më të mira të mundshme të punës, një linjë me praktikën më të mirë të njohur ndërkombëtare

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar prej **35 (tridhjet e pesë) punonjës** për periudhën e fundit **3 (tre)** mujore (Prill, Maj, Qershor 2024), ku Stafit Teknik dhe punetoret e kualifikuar të jenë me kohe të plote pune për periudhën e fundit **3 (tre)** mujore (Prill, Maj, Qershor 2024).

Per vertetimin e ketij kushti te paraqiten:

- Vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore/ose Tatimore
- Listpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar më sipër dhe të jenë të konfirmuara nga Dega Rajonale Tatimore ku është i regjistruar subjekti.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.

Argumentim: Ky kriter është vendosur në baze të pikës 4, nenit 77, të ligjit nr 162 datë 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik” dhe nenit 39, Pika 6/ç, të VKM nr 285, datë 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të ketij kriteri kërkohet që operatorët ekonomik të deshmohen që kanë fuqi minimale puntore, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Autoriteti kontraktor në përcaktimin e fuqisë puntore të nevojshme për realizimin e kontratës ka bërë një përllogaritje të numrit të punnjësve duke përcaktuar fillimisht orët e punës në bazë të analizës sipas manualit teknik të çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr 216 Datë: 13.04.2023” Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemit të Integruar për Informatizimin e Manualit të Çmimeve për Zërat e Punimeve në Ndërtim në këtë kontekst autoriteti kontraktor ka përcaktuar numrin e punonjësve referuar një përllogaritje të saktë të bërë referuar zërave të punimeve për objektin e prokurimit orëve të punës (8 orë në ditë për çdo punonjës) afatit kohor të realizimit të kontratës si dhe shpërndarjes së punës. Në numrin e përcaktuar për fuqinë puntore janë përllogaritur stafit teknik dhe inxhinjerik si dhe stafit administrativ. Nga përllogaritja e orëve të punës për çdo zë pune rezulton se për kryerjen e punimeve sipas grafikut të punimeve duhen **35 (tridhjet e pesë) punonjës** me kohe të plote.

Nr	Nr.An	Pershkrimi i punimeve	Nje sia	Sasia	Ore pune	Ore totale	Ore pune m.	Ore totale
1.Argjinatura						34,029.38		4,151.30
1	3.100/b	Germim dheu me ekskavator zingjir 0.25 m ³ , në kanale gjeresi > 2 m, prani uji ~ 2m, kategoria III, me shk në mjet	m ³	1,041		0	0.093	96.813
2	Oferte	Mbushje me zhavorr pas mureve,(argjinatura)	m ³	4,600	0.34	1564		0
3	3.353	Mbushje me zhavorr pas mureve (pas mureve+gabionit)	m ³	1,633	3.7	6042.1	0.2	326.6
4	3.183/a	Shtrese zhavor lumi t=10cm(muri I betonit)	m ²	455	0.02	9.1	0.13	59.15
5	2.262/3	Shtrese betoni C 12/15(muri I betonit)	m ³	41	8.6	352.6	0.73	29.93
6	2.519	Tub Ø90 mm për kullimin e ujrave në mure (muri I betonit)	ml	466	1.43	666.38		0
7	3.245	Struktura monilite betoni C25/30 (muri I betonit)	m ³	849	12.8	10867.2	2.29	1944.21
8	3.243	Struktura monolite betoni C 16/20(argjinatura)	m ³	740	12.8	9472	2.29	1694.6
9	3.331	Gabiona me rrjete teli të zinguar e gure kave 1x1x1 m	m ³	320	5.6	1792		0
10	3.333	Gabiona me rrjete teli të zinguar, gure kave 1x1x2 m	m ³	640	5.1	3264		0
11	2.37/3a	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 3.0 km	m ³	416		0		0

2.Sistemimi i kanalit						1,058.31		496.66
1	3.100/b	Germim dheu me ekskavator zingjir 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, prani uji ~ 2m, kategoria III, me shk ne mjet	m ³	675		0	0.093	62.775
2	3.396/1	Mbushje me zhavorr pas mureve,(kesoni)	m ³	403	0.04	16.12	0.04	16.12
3	3.183/a	Shtrese zhavor lumi t=10cm(kesoni)	m ²	403	0.13	52.39	0.02	8.06
4	2.262/3	Shtrese betoni C 12/15(kesoni)	m ³	38	8.6	326.8	0.73	27.74
5	Oferte	Kesone b/a	ml	114	5	570	2.04	232.56
6	Oferte	Spostim I linjave te kanalizimeve qe derdhen ne perrua	ml	100	0.2	20	0.72	72
7	Oferte	Zhbllokim i linjave te kanalizimeve ekzistuese	ml	45	1	45	1.72	77.4
8	3.966	F.V Fidane Peme dekorative	cope	28	1	28		0

Totali ore pune puntori $35,087.7 / (8 \times 22 \times 7) = 28$

Totali ore pune puntori per makinerit $4,647.96 / (8 \times 22 \times 7) = 4$

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje 3 (tre) muajt e fundit tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit i parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruar me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpigjet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarres, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor, mbështetes, punonjësit specialiste dhe çertifikimet perkatëse, si me poshte:

a) Operatorët ekonomik pjesëmarres duhet të kenë në licencë të shoqërisë e të punësuar si drejtues Teknik në stafin e tij për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontrate pune të vlefshme, diplome, CV, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.4, stafin inxhinierik si me poshte:

- **1 (nje) Inxhinier Ndërtimi**
- **1 (një) Inxhinier Gjeoded (Topograf)**
- **1 (nje) Inxhinier Hidroteknik**
- **1 (nje) Inxhinier Gjeoteknik**
- **1 (nje) Inxhinier Mjedisi**

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në paragrafin 3 të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv.
- **Inxhinieri gjeodet/topograf** është kërkuar duke ju referuar edhe pikës së licencës së kërkuar për shkak se kemi të bëjmë me argjinature dhe projekti parashikon përmirësimin e gjeometrisë horizontale e vertikale të saj. Piketimi dhe kontrolli topografik duhet bërë në çdo fazë të zbatimit të punimeve. Duke ju referuar projektit dhe realcionit përshkrimor, me qëllimin për realizimin me cilësi dhe kushte sipas standarteve.
- **Inxhinier Hidroteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet referuar punimeve të parashikuara në preventiv per nr. e analizave 2.519, si dhe nr. te analizes (oferte) ne nr. 6 dhe 7 te punimeve per sistemimin e kanalit.
- **Inxhinier Gjeoteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet referuar punimeve të parashikuara në preventiv (sistemimi i kanalit) respektivisht në nr. 3, 4 dhe 6.
- **Inxhinier Mjedisi** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet duke qene se kemi te bejme me punime ne argjinature dhe sisteme te kanalizimeve te cilat rrjedhimisht mund te sjelin ndotje mjedisore te cilat kerkojne vemendjen e nevojshme nga inxhinier specifik.

b) Stafi mbështetes Operatori ekonomik duhet te kete te disponoje dokumentacionin qe verteton profesionin si: Deshmi profesionale te punonjesve ose ekuivalent te tij/saj, , punonjesit e meposhtem me specialitetin si dhe te figurojn ne listpagesat e shoqerise sipas pikes mesiperme (2.3.4):

- 1 (nje) Teknik i mesem Ndërtimi (Diplome e shkolles mesme)
- 5 (pesë) specialist guri (gurëgdhendës) (Me Certifikate Trajnimi / Diplome)
- 4 (kater) Betonues (Me Certifikate Trajnimi / Deshmi Profesionale)
- 4 (kater) Karpentier (Me Certifikate Trajnimi / Deshmi Profesionale)
- 5 (pese) puntore te thjeshte

* Ne lidhje me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje dokumentacionin qe verteton profesionin si :

- Kontratat e punes individuale te vlefshme
- Per stafin e mesiperm, Deshmia e kualifikimit/ certifikate dhe/ose diploma e cila te jete e leshuar nga Ministria e Financave ose te njihet nga Ministria e Punes Ceshtjeve Sociale te paraqitet certifikata/diploma profesionale per secilin. Certifikatat / diplomat duhet te jene te leshuara nga institucione publike/private te licensuara sipas ligjit nr. 15/2017 “*Per arsimin dhe formimin profesional ne R.Sh.*”, i ndryshuar. Kjo kerkese po ashtu eshte ne perputhje me vendimin nr. 441/2020, date 09.10.2020 te Komisionit te Prokurimit Publik. Diplomat/certifikatat e paraqitura nga organizma te cilat nuk jane te licencuara sipas legjislacionit ne fuqi do te konsiderohen si dokumenta te rreme te cilat perbejne shkak per skualifikim dhe/ose perjashtimin e ketij kontraktori nga pjesemarrja ne prokurimet publike.
- Certifikate te sigurimit Teknik e vlefshme, leshuar nga institucione te autorizuar nga /ish (IQT) e cila te jete e leshuar nga shoqeri te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise
- *Diplome nga institucionet e arsimit te mesem profesional(publik/privat) te akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne RSH”, kontrate pune te vlefshme dhe te figuroje ne listpagesa.*
- Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit te

meposhtem:

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit të marredhënieve të punës	Nr. Amzes/ekuivalent diplomes / certifikates profesionale	Institucioni/ Subjekti certifikues	Data e vlefshmerise se certifikates profesionale
----	--------------	------------	---	---	------------------------------------	--

Kriteri konsiderohet i permushur me paraqitjen e formularit të vetedeklarimit sipas shtojces 8 të DST.

Shenim: Referuar pikes 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: *“Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si prove paraprake, ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetedeklarimit, sipas percaktimit në nenin 82, të LPP-se, dhe në këto rregulla”*, si dhe percaktimet e pikes 6, të ketij neni, ku parashikohet: *“Perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorezimin e dokumenteve provuese të parashikuara ne shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikes 2 të ketij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqeruese të ofertes, të dorezuara ne rruge elektronike. Keto dokumente duhet të paraqiten ne origjinal ose ne kopje të njesuara me origjinalin”*.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në paragrafin 3 të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Numri është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Teknik i mesem Ndërtimi** referuar specifikimeve teknike bashkëlidhur projektit tekniku i ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit duke siguruar kështu kontrollin e cilësisë së punime në të gjitha fazat e zbatimit të projektit.
- **Specialist guri (gurëgdhendës)** duke qene se kemi te bejme me rehabilitim te argjinatures si dhe referuar specifikimeve teknike bashkelidhur projektit si dhe preventivit te punimeve specialistet e gurit jane te nevojshem per punimin e gurit konkretisht ne preventiv perkatesisht per analizat nr. 3.331 dhe 3.333.
- **Betonues** bazuar në të gjithë zërat e punimeve sipas preventivit si dhe të volumeve që do të kryhen kërkohet që operatori ekonomik të disponojë betonues të cilët do të realizojnë këto punime konkretisht an. Nr. 2.262/3, 3.245 dhe 3.243..
- **Karpentier** bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit si dhe të volumeve që do të kryhen kërkohet që operatori ekonomik të disponojë karpentier të cilët do të realizojnë këto punime konkretisht an. Nr. 3.331 dhe 3.333.
- **Puntore të thjeshtë** bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit si dhe të volumeve që do të kryhen.

c) Operatorët ekonomik pjesemarrës duhet të kenë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vertetuar me kontratë pune të vlefshme, të pajisur me çertifikate/dëshmi trajnimi të leshuar nga subjekte të akredituar sipas ligjit, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kerkuar në pikën 2.3.4 ose mund të përmbushë edhe

nepermjet kontrates se sherbimit, punonjes me specialitetin si me poshte:

□ **Minimumi 1 (nje) person** qe permbush kriteret per te qene **“Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune”**

□ **Minimumi 1 (nje) person** qe permbush kriteret per te qene **“Ekspert Zjarrfikes i pajisur me Licence**

I.2.A ne perputhje me piken 4, te nenit 49, te Ligjit Nr.152/2015 “Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin”. Per kete duhet te paraqitet Certificate/deshmi per ekspert zjarrfikes te leshuar nga Ministria e Puneve te Brendeshme, diploma dhe kontrata noteriale e punes.”

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” I ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Në mbështetje të nenit 7 të Ligjit Nr:10 237, datë 18.02.2010 ”Për sigurinë dhe shëndetin në punë” ku citohet. “Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale nëndërmarrje/institucion.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet te deshmoje se ka te punesuar ne stafin e shoqerise punonjes te kualifikuar, te pajisur me Deshmi te Aftesive Profesionale (DAP), leshuar nga D.P.SH.T.RR., minimalisht si me poshte :

- Eskavatorist 3 (tre)
- Automakinist 2 (dy)
- Shofer 3 (tre)

Në rastin kur makineritë disponohen me qera, drejtuesit e ketyre mjeteve mund të disponohen nga operatori ekonomik edhe nëpërmjet kontraktimit.

Per kete operatoret ekonomike duhet te paraqesin :

- Kontratat e punes te vlefshme;
- Dokument (deshmi kualifikimi profesional), qe te vertetoje kualifikimin profesional te kerkuar, referuar rregullores “Per kushtet, kriteret dhe programet per pergatitjen teoriko-praktike te kandidateve, si dhe dhenien e Deshmise se Aftesise Profesionale per perdoruesit e makinerive te renda per punime ndertime dhe toke, si dhe disiplinimi i perdorimit te tyre”, miratuar me urdherin nr. 200, date 16.5.2019, te Ministrit te Infrastruktures dhe Energjitikes.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet plotesimit dhe paraqitjes nga operatoret ekonomike te formularit perbledhes te vetedeklarimit, sipas shtojces 8 te DST.

Dokumentacioni provues do te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar ne vend te pare, prane autoritetit kontraktor, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, ose nese do te jete nevoja per tu kerkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqine minimale punetore te nevojshem per ekzekutimin e objektit. Specialistet e mesiperme jane vendosur ne perputhje me llojin e kontrates, analiza e zerave te punimeve dhe objektin qe ndertohet me nje numer te mjaftueshem per realizimin me sukses te punimeve.Duke pasur parasyh numrin dhe llojin e makinerive qe perkojne me oret e punes sipas

zerave te analizes teknike , grafikun e punimeve eshte vendosur edhe numri i manovratoreve.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesemarres duhet te kete licence lidhur me ndikimin ne mjedis te leshuar nga QKL kodi III.2.B **“Grumbullim dhe transportim i mbetjeve te llojeve te ndryshme”, kjo License mund te jete me kontrate sherbimi. (arsyetim/diskutim)**

2.3.8 1 (një) ekspert mjedisi i pajisur me çertifikatën e Vlerësimit te Ndikimit në Mjedis i cili duhet të rezultojë në listpagesat e shoqërisëte pakten 3 (tre) muajt e fundit, vertetuar me kontratë pune dhe certifikaten perkatese

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Vendim nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet te paraqese Kontate Furnizimi shoqëruar me autorizim per Materialet si me poshtë:

- a. **Kesone betone arme:** Autorizim Prodhuesi/Distributori
- b. **Beton:** Shoqëruar me Fletë Analize Testimi Betoni nga Laborator i akredituar

Argumentimi:

Ligjor: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Teknik: Për shkak të rëndësis së objektit të ndërtimit dhe kryerjes së punimeve me cilësi, materialet që do të përdoren në këtë objekt duhet ti plotesoje të gjitha normat dhe rregullat teknike të aplikuara në vendin tonë (të parapara sipas kontratës për ekzekutimin e punimeve).

Betoni duhet te levizet nga vendi i pergatitjes ne vendin e vendosjes perfundimtare sa me shpejt ne menyre qe te pengohet ndarja ose humbja e ndonje perberesi.

Kesonet duhet të jenë të llogaritura sipas peshes efektive, siç është konfirmuar nga pesha specifike e pranuar nga te dyja palet ne raport, pesha efektive e çdo elementi ne asnje menyre nuk duhet te jete me e vogel se pesha teorike e zvogeluar me asnje tolerance.

2.3.10 (Makineri, Pajisje)

- a) **Operatori ekonomik pjesemarres, per realizimin e kontrates, duhet te disponoje, automjetet dhe pajisjet (sipas tabelës) te cilat duhet te jene ne pronesi te tij ose me qira te vertetuara keto me dokumentacionin perkates;**

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes 16 – 18 ton	4 cope	Pronesi ose me qera
Kamioncinë me kapacitet deri në 3 ton	2 cope	Pronesi ose me qera
Ekskavator me goma (mjet teknologjik me goma)	2 cope	Pronesi ose me qera
Eskavator me zinxhir mbi 40 ton	1 cope	Pronesi ose me qera
Dumper me goma (mjet teknologjik me goma) 4ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Dumper me goma (mjet teknologjik me goma) 6 ton	1 cope	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhir krahegjate mbi 21 m	1 cope	Pronesi ose me qera

Minieskavator me goma (mjet teknologjik me goma)	1 copë	Pronesi ose me qera
Autovinc 5-12	2 cope	Pronesi ose me qera
Autobot uji	1 cope	Pronesi ose me qera
Autobot thithës me vakum dhe sondë me presion (mjet teknologjik me goma)	1 cope	Pronesi ose me qera
Automjet transporti per mbetjet biologjike (mjet teknologjik me goma) (sipas analizës së zerit të punimeve zhbllokim linjave)	1 cope	Pronesi ose me qera
Depozite uji 5000 l	1 cope	Pronesi ose me qera
Autobetoniere	1 cope	Pronesi ose me qera
Autobetoniere kantieri (mjet teknologjik me goma)	1 copë	Pronesi ose me qera
Betoniere 0.25-0.5 m ³	2 cope	Pronesi ose me qera
Rrul me dhëmbë	1 cope	Pronesi ose me qera
Grejder (mjet teknologjik me goma)	1 cope	Pronesi ose me qera
Fadrome	1 cope	Pronesi ose me qera
Instrument per punime gjeodezike	1 cope	Pronesi ose me qera
Fabrike Betoni pajisur me QKL / mobile e levizeshme, jo më larg se 40 km nga vendi i punimeve	1 cope	Pronesi, me qera ose aktmarveshje furnizimi
Nyje inerte (per mbushje me zhavorr pas mureve)	1 cope	Pronesi, me qera ose aktmarveshje furnizimi
Akt marrëveshje laborator testimi betoni	1 copë	Pronesi, me qera ose aktmarveshje furnizimi

b) Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtëse në punë të punëtoreve, personelit, si më poshtë:

- Kokore – jo me pak se 35 cope
- Jeleke – jo me pak se 35 cope
- Prozektore ndriçimi natën – jo me pak se 4 cope
- Komplet i ndihmes së shpejte – jo me pak se 5 cope
- Fikese zjarri të levizshme me kapacitet 5-7 litra – jo me pak se 5 cope
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – jo me pak se 10 cope
- Ripa sigurie – jo me pak se 35 cope

Per vertetimin e disponimit të makinerive dhe pajisjeve të kerkuara me lart, të paraqiten:

1- Per mjetet që shenohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokument që verteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*te vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*te vlefshme*).

2- Per mjetet e siguruar me qira, të paraqitet kontrata e lidhur për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronesie origjinal ose fotokopje të noterizuar plus dokumentat që verteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*te vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*te vlefshme*).

3- Per paisjet në pronesi të shoqërohen me Akt - Pronesie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklarate zhdoganimi*).

4- Per paisjet me qera të paraqitet kontrata e lidhur për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronesie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklarate zhdoganimi*).

5- Operatori ekonomik nuk duhet t'i ketë kapacitetet teknike të angazhuara në kontratat të tjera dhe nuk duhet të jenë të deklaruar në procedurë të shpallura fituese (**deklarate me shkrim nga Administratori i Shoqërisë**)

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes se nje dokumenti, ose dokumente false dhe te pasakta,

Argumentimi:

Ligjor: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Gjithashtu kriteri është vendosur referuar zerave te punimeve.

Teknik: Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar ne VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim .”

Konkretisht:

- Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes 16 – 18 ton *u referohet analizave Nr. 3.183/a; 2.262/3; 2.37/a; 3.396/1; ofertes me nr. Rendor 5 (sistemimi i kanalit)*
- Kamioncinë me kapacitet deri në 3 ton ton *u referohet analizave Nr. 3.183/a; 2.262/3; 3.396/1; ofertes me nr. Rendor 5 (sistemimi i kanalit)*
- Ekskavator me goma (mjet teknologjik me goma) *i referohet analizës Nr. 3.100/b;*
- Eskavator me zinxhir mbi 40 ton *i referohet analizës Nr. 3.100/b*
- Dumper me goma (mjet teknologjik me goma) 4ton *i referohet analizës me nr. Rendor 7 (sistemimi i kanalit)*
- Dumper me goma (mjet teknologjik me goma) 6 ton *i referohet analizës me nr. Rendor 5 (sistemimi i kanalit)*
- Eskavator me zinxhir krahegjate mbi 21 m *i referohet analizës Nr. 3.100/b*
- Minieskavator me goma (mjet teknologjik me goma) *i referohet analizës Nr. 3.100/b;*
- Autovinc 5-12 *u referohet analizave Nr. 2.262/3; analizës me nr. Rendor 5 (sistemimi i kanalit)*
- Autobot uji *i referohet analizës me nr. Rendor 7 (sistemimi i kanalit)*
- Autobot thithës me vakum dhe sondë me presion (mjet teknologjik me goma) *i referohet analizës me nr. Rendor 7 (sistemimi i kanalit)*
- Automjet transporti per mbetjet biologjike (mjet teknologjik me goma) *i referohet analizës me nr. Rendor 6 dhe 7 (sistemimi i kanalit)*
- Depozite uji 5000l *i referohet analizës me nr. Rendor 7 (sistemimi i kanalit)*
- Autobetoniere *u referohet analizave Nr. 2.262/3; 3.243; 3.245*
- Autobetoniere kantieri (mjet teknologjik me goma) *u referohet analizave Nr. 2.262/3; 3.243; 3.245*
- Betoniere 0.25-0.5 m³ *u referohet analizave Nr. 2.262/3; 3.243; 3.245*
- Rrul me dhëmbë *i referohet analizës Nr. 3.183/a*
- Grejder (mjet teknologjik me goma) *u referohet analizave Nr. 3.353; 3.183/a*
- Fadrome *i referohet analizës Nr. 3.396/1*
- Instrument per punime gjeodezike *u referohet analizave Nr. 3.353; 2.519; 3.243; 3.245; 3.396/1; 3.183/a 2.262/3 si dhe analizës me nr. Rendor 6 dhe 7 (sistemimi i kanalit)*
